



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 52
Prishtinë, më 13.07.2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj –Bujupi, Haset Cakolli, Ismajl Kurteshi.

Munguan : Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri – Ministër i Kulturës, Rinisë e Sporteve, përfaqësues të federatës së Futbollit, Ping Pongut, Mundjes, përfaqësues të Komitetit Olimpik si dhe përfaqësues të Kolegjiut të Drejtorive të Arsimit.

Në mbledhje prezent ishin mediat e Kuvendit dhe përfaqësues të mediave tjera elektronike

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë : Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 07.07.2010,
3. Shqyrtimi i shkresës së Fakultetit të Edukimit për mos regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Edukimit në Prizren dhe Gjilan,
4. Raportimi i ministrit të kulturës lidhur me gjendjen në sportin kosovar
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua, me ndryshimin e renditjes së pikave 3 dhe 4.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 07.07.2010.

Procesverbali i mbledhjes së datës 07.07.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të kulturës lidhur me gjendjen në sportin kosovar

Kryesuesi lidhur me këtë pikët të rendit të ditës fjalën ia dha ministrit të Kulturës, Rinisë e Sporteve z.Lutfi Haziri.

Lutfi Haziri – i njoftoi anëtarët e Komisionit rreth angazhimeve të Ministrisë lidhur me sportin i cili konsiderohet si sektor i rëndësishëm së veçantë duke pasur parasysh se pjesa dërmuese e popullatës është e re. Departamenti i Sportit ka mbështetur dhe ka ndihmuar zhvillimin e aktiviteteve të shumta sportive, përmes të cilave synon të kontribuojë në organizimin përmbajtjesor, zhvillimin e kuadrove, anëtarësimin dhe licencimin e sportit kosovar në arenën ndërkombëtare, përfshirjen e të gjithëve në aktivitete sportive, pa dallim kombi, race e përkatësie fetare. Më tej shtoi se Ministria është në proces të përfundimit të Strategjisë së Sportit e cila do të shërbejë si një kornizë për zhvillimin dhe avancimin e sportit në përgjithësi. Po ashtu ai njoftoi komisionin se Strategjia për Sportin, Ligji për Sportin dhe Ligji për Sponzorimet pritet që të procedohen në Qeveri dhe shpreson që në sesionin vjeshtor ato të dërgohen në Kuvend.

Adem Hajdaraj – shtoi çështjen e pranimin të Federatave tona në Federatat Ndërkombëtare të Sportit. Ai kërkoi sqarim se ku qëndron problemi i mos pranimin të disa federatave duke pasur parasysh se disa nga to tanimë janë pranuar ndërkombëtarisht.

Heset Cakolli - tha se Komisioni duhet të angazhohet që sa më shpejt të miratohet legjislacioni në fushën e sportit në mënyrë që të mbulohet zbrastësia ligjore duke pasur parasysh se sporti është një segment shumë i rëndësishëm i shoqërisë në të cilin duhet të investohet me shumë.

Donika Kadaj – Bujupi – kërkoi sqarim nga ministri lidhur me zhvillimet e fundit në basketboll duke pasur parasysh se në këtë sport vitet e fundit vërehet një degradim. Lidhur me Strategjinë e Sportit, ajo kërkoi sqarim lidhur me përmbajtjen si dhe afatet kohore lidhur me zbatimin e Strategjisë.

Enis Kervan - tha se si Komision jemi të gatshëm që të japim kontributin tonë që sporti të ndërkombëtarizohet, kërkoi sqarim se a ka të dhëna statistikore lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve me aktivitete sportive si dhe të dhënat rreth pjesëmarrësës së personave me nevojë të veçanta në aktivitete sportive.

Drita Kadriu - ngriti çështjen e ndërkombëtarizimit të sportit si dhe në rrafshin e dytë në aspektin e edukimit sportiv. Ne këtë kontest mendon se duhet të investohet me tepër në edukimin sportiv si dhe kërkoj që të përkrahet sporti femëror.

Ismail Kurteshi - kërkoj sqarim lidhur me arsyet e qe e pengojnë ndërkombëtarizimin e disa federatave duke pasur parasysh se katër nga federatat janë pranuar ndërkombëtarisht.

Arsim Rexhepi - kërkoj nga Ministri afatin e dërgimit të legjislacionit në fushën e sportit, si dhe çka nënkuptohet me arbitrazhin si cilat janë veprimet e Ministrisë në rastet kur kemi të bëjmë me kurdisje të rezultateve në ndeshjet sportive.

Donik Kadaj – Bujupi – kërkoj sqarim lidhur me mënyrën e përkrahjes së sportit sipas Ligjit për Sponzorimet. Ajo kërkoj të formohet një Komision nga Ministria me qëllim të vëzhgimit të infrastrukturës sportive nëpër shkolla si dhe kërkon sqarim lidhur me mos përfundimin e projektit rreth rregullimit të stadiumit të futbollit në Istog.

Lutfi Haziri - lidhur me çështjet e ngritura nga ana e anëtarëve të komisionit, tha se me miratimin e Strategjisë për Sportin dhe legjislacionin përkatës do të vihen kornizat dhe politikat programore lidhur me zhvillimin e sportit. Sa i përket ndërkombëtarizimit të sportit kosovar, ministri tha se kjo çështje është me tepër politike dhe se varësisht nga statutet e Federatave ndërkombëtare bëhet edhe ndërkombëtarizmi i sportit tonë ne këtë kontest rol të posaçëm kanë edhe Ministria e Punëve të Jashtme, Komisionet parlamentare etj. Sa i përket Arbitrazhit si tha se ky është një lloj gjyqi të cilin e shfrytëzojnë për të zgjidhur kontestet ne fushën e sportit. Kjo është një sfidë e cila kërkon mjete te veçanta buxhetore.

Përmes politikave programore Departamenti i Sportit ka kontribuar në avancimin e sportit të Kosovës në fusha të ndryshme, dhe brenda kapaciteteve shumë të kufizuara buxhetore ka ndihmuar në përmirësimin e gjendjes shumë të vështirë në segmentet specifike të sportit. Infrastruktura e mbyllur është ajo që më së shumti i mungon sportit të Kosovës, ndërsa përmirësimet në këtë aspekt do të siguronin kushtet elementare për zhvillimin e shumë aktiviteteve sportive.

Organizimi i sportit përmes garave nëpër shkolla fillore dhe të mesme është qëllim kryesor për identifikimin e talentëve të rinj dhe orientimin profesional të tyre.

Këto organizime do të mbahen në bashkëpunim me Federatat e Sporteve, me Departamentet komunale të Arsimit dhe Sportit, Ministrinë për Arsim etj. Përmes këtyre garave të sportit shkollorë do të subvencionohen edhe shkollat më të suksesshme për pjesëmarrje në gara sportive ndërkombëtare të prezantojnë kualitetin e sportit Kosovar.

4. Shqyrtimi i shkresës së Fakultetit të Edukimit për mos regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Edukimit në Prizren dhe Gjilan

Kryesuesi lidhur me këtë pikët të rendit të ditës fjalën ia dha kryetarit të Kolegjiut të Drejtorive Komunale të Arsimit.

Azem Guri – foli lidhur me bashkëpunimin e Drejtorive të Arsimit në nivele komunale, mënyrën e organizimit dhe mënyrës së identifikimit të problemeve nga fusha e arsimit. Ai theksoj se do të bashkëpunoj me Komisionin në çështjet e fushës së arsimit.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se me bashkëpunimin me Kolegjiut të Drejtorive të Arsimit do të shkëmbejnë përvoja në çështjet e identifikuar si çështja e konkurseve, zgjedhja e drejtorëve, cilësisë së mësimdhënies, rezultateve të testeve etj.

Lidhur me çështjen e Fakultetit të Edukimit anëtarët e komisionit nuk morën ndonjë qëndrim nga se për këtë çështje mungon vendim i Ministrisë.

Kryesuesi – njoftoj anëtarët e komisionit se këtë vit akademik nuk është akredituar asnjë program në fakultetin e edukimit në Prizren dhe Gjiçan.

Donika Kadaj – Bujupi- kërkoj të sqarohet vendimi i Agjencisë së Akreditimit dhe Vendimi i ministrisë ndërsa pas marrjes së vendimeve të debatohet në Komision për arsyet e mos akreditimit.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se në mbledhjen e radhës të ftohen Ministri i Arsimit, Drejtori i arsimit të lartë, përfaqësues të Agjencisë së Akreditimit.

5. Të ndryshme

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte shqyrtoi dhe miratoi Listën me emrat e ekspertëve për Komisionin :

1. Kujtim Shala Profesor fakulteti
2. Nysret Krasniqi Fakulteti i Filologjisë
3. Ejup Qerimi Fakulteti Elektroteknik,
4. Gazmend Syla, Fakulteti i Filologjisë,
5. Masar Stavileci, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës,
6. Bashkim Thaqi Fakulteti i Shkencave Matematike- Natyrore,
7. Qemajl Sokoli, Profesor në Akademinë e Arteve në Prishtinë.
8. Bedri Muhadri, Fakulteti Filozofik-Departamentin e Historisë,
9. Munamet Avdyli, Fakulteti Teknik – Elektroteknik – Prishtinë,
10. Basri Muja, Fakulteti Juridik,
11. Fisnik Qavolli Kolegji Tempulli - trafiku rrugor
12. Fetnan Dervish magjistër i historisë
13. Todoroviq Sonja
14. Azem Kyqyku Fakulteti Teknik,
15. Melinda Mula FSHMN profesoreshe
16. Sebahate Grajqevci MA ekonomise

Komisioni kërkoj që për ekspertin e propozuar Todoroviq Sonja të plotësohen të dhënat me dëshmi mbi kualifikimin.

Komisioni vendosi që për mbledhjen e ardhshme me dt.14.07.2010 të diskutohet kjo çështje dhe të ftohen përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Drejtori i arsimit të lartë, përfaqësues të Agjencisë së Akreditimit.

Mbledhja e ardhshme do të mbahet me dt. 14.07.2010 në ora 13:00.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14: 00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi